

PARTIA E GJELBER

TIRANE

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR

**Per auditimin ligjor të Fondeve të përfituara dhe te shpenzuara
për fushatën zgjedhore, per zgjedhjet Kuvendore 2013.**

Tirane 24 Shtator 2013



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

KOMISIONINI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Bulevardi: “Dëshmoret e Kombit”
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.752, dt.02.08.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës së Shërbimit të lidhur midis paleve me date 02.09.2013, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet Kuvendore me date 23 Qershor 2013.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë së Gjelber Tirane. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arketimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.

Pasqyrat bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti zgjedhor Partia e Gjelber ,për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet Kuvendore , që fillon me dt.23.05.2013 dhe mbyllet me dt. 23.06.2013 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arketimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Firma : Lavdimir Fusha
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

Tirane , me 24 Shtator 2013



I . INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

I.1 Baza ligjore kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë prane Partisë se Gjelber Tirane.

I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia e Gjelber Tirane e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar,ne baze te Vendimit te Ministrise se Drejtesise.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”, nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor Partia e Gjelber Tirane është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e partise është në adresen : Rr. Bulevardi “Bajram Curri”, Pall. 31, Shk. 1, Ap. 4, Tirane. Kontakte te tjera : E-mail:office@pgj.al, [htt://www.pgj.al](http://www.pgj.al)

Organet drejtuese ne udheheqijen qendrore janë:

- Kongresi
- Keshilli kombetar
- Kryesia
- Komisioni Qendror i Kontrollit

Kryetar i partise është zgjedhur z.Edlir PETANAJ, i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partise se Gjelber.



Te ardhurat Financiare te Partise perbehen nga :

- Kuotat e patrise
- Buxheti i shtetit, sipas ligjit per financimin e partive politike.
- Te ardhurat nga shfrytezimi i pasurive te tundeshme dhe te pa tundeshme te partise
- Te ardhurat nga ndermarjet e partise
- Te ardhurat nga veprimtaria botuese e partise
- Nga ndihmat e dhuratat nga anetaret dhe simpatizantet e partise
- Mjetet e dhuruara me testament partie
- Te ardhurat nga veprimtarite me pagese
- Te ardhura te tjera ne perputhje me ligjet e shtetit. Kontribute vullnetare te qytetareve, institucioneve, ndermarjeve, organizatave, etj.

II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

- a) Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- b) Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- c) Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve. Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.
- d) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve. Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- e) Të Ardhurat
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.



2 ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve ,

A. Te ardhura te perfituara ne shumen 111,321 Leke , te perbera nga :

1. Nga buxheti i shtetit sipas ligjit per financimin e partive politike ... 61,321 leke ,
2. Donacione dhe kontribute vullentare nga antaret..... 50,000 leke ,

Financimi nga buxheti i shtetit eshte kaluar nepermjet llogarise bankare , kurse donacionet nepermjet arkes duke plotesuar pasqyrat dhe deklaratat sipas formes se miratuar ne vendimin e KQZ-se nr. 266, date 01.06.2009.

B. Te shpenzuara ne shumen 108,017 Leke , te perbera nga :

1. Flete palosje – Broshura 49,800 leke,
2. Spot publicitar 52,060 leke,
3. Printim me adeziv..... 6,157 leke,

Shpenzimet e mesiperme, jane mbartur ne fatura te rregullta tatimore te leshuara nga subjektet private, ne baze te legjislacionit fiskal.

C. Gjendja e likuiditeteve :

Ne mbyllje te fushates zgjedhore gjendja e likuiditeve ne llogarite bankare dhe ne arke, per ato te celura vetem per fushaten eshte 3,304 leke.

3. NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Firma : Lavdimir Fusha
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

Tirane , me 24 Shtator 2013

PARTIA E GJELBER

(Te gjitha shumat jane ne leke)

PASQYRA E TE ARDHURAVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA FUSHATA ZGJEDHORE PER ZGJEDHJET KUVENDORE 2013

Te ardhura Shpenzime për periudhën zgjedhore	Shenimi nr.	Periudha 23.05.2013 deri 23.06.2013
Burimet (te ardhurat) nga:		
Kuota e antarsisë	8	0
Fonde publike nga shteti	9	61.321
Dhurime nga persona fizik dhe persona juridik	10	50.000
Burime të tjera	11	0
Totali i te burimeve		111.321
Shpenzime (perdorime)		
Perdorimet per veprimtarine kryesore		
Marrje salla me qira	12	0
Reklama televizive	13	0
Reklama ne radio	14	0
Spote publicitare	15	52.060
Shpenzime për postera, fletëvolante, fletëpalosje	16	49.800
Shpenzime kancelarie	17	6.157
Shpenzime për karburant	18	
Pagesa e firmave konsulente	19	0
Pagesa për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	20	0
Totali i shpenzimeve		108.017
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore (1-2)		3.304
Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi	21	0
Nentotali i to ardhurave dhe shpenzimeve financiare		0
Teprica e burimeve neto e vitit financiar	22	3.304

Edlir PETANAJ

Kryetari i Partise se Gjelber